

MEMO

<i>Datë:</i> 30 Korrik 2020	
Për: Armend Zemaj, Ministër i Shëndetësisë	Nga: Lul Raka, Kryesues i Bordit Këshillëdhënës për Covid-19
RAPORT NGA MBLEDHJA E TRETË E BORDIT KËSHILLËDHËNËS PËR COVID-19	

PËRMBLEDHJE E QËNDRIMEVE TË BORDIT KËSHILLËDHËNËS ANTI-COVID 19

- Të adresohet shkalla e lartë e vdekshmërisë së pacientëve
- Të rritet numri i testeve në kujdesin parësor
- Të mbahen testet e Arritshmërisë dhe ai i Maturës nga MASHT
- Parashkollorët dhe nxënësit deri në klasën e pestë të vijojnë mësimin në shkolla
- Të hapen shkollat profesionale për mbajtjen e lëndëve profesionale dhe atyre praktike
- Miratohet kërkesa e Komitetit Olimpik të Kosovës për lejimin e stërvitjes për sportet elitare olimpike dhe për skuadrat e kualifikuara në garat evropiane
- Raportet e mbledhjeve të Bordit të bëhen publike në veb faqen e Ministrisë së Shëndetësisë.

1. TË ADRESOHET SHKALLA E LARTË E VDEKSHMËRISË- (SHSKUK)

- Të zbatohen këshillat e propozuara për fuqizim të koordinimit dhe menaxhimit në SHSKUK në mbledhjen e dytë të Bordit, të mbajtur më 25.7.2020
- Të kërkohet mbështetje profesionale nga shtetet mike dhe organizatat ndërkombëtare, me të cilat Kosova ka marrëveshje bashkëpunimi (Gjermania, Italia, Turqia, OBSH, ECDC, etj.)
- Bordi Drejtues i SHSKUK të ngrisë urgjentisht shkallën e koordinimit dhe integritit të shërbimeve në menaxhimin klinik të rasteve
- Të trajnohet personeli në spitalet e përgjithshme për menaxhimin klinik të rasteve nga profesionistët e Klinikës Infektive dhe Anesteziologjisë
- Të planifikohet kyçja e spitaleve private në menaxhimin klinik të pacientëve me COVID-19
- Të ngriten kapacitetet e shtretërve (Spitali në FSK, spitali fushor)
- Të përgatiten raporte analitike nga mbikqyrja e të dhënave epidemiologjike dhe klinike në IKSHPK dhe SHSKUK

2. TË RRYTET NUMRI I TESTIMEVE NË KUJDESIN PARËSOR

Rezultatet e hulumtimeve të fundit shkencore në botë, të ndërlidhura me mortalitetin nga COVID-19 dëshmojnë se ky tregues ka një korrelacion negativ me numrin e të testuarve në 100 persona, me performancën qeveritare dhe me përqindjen e personave mbi 65 vjeç në popullatën e përgjithshme. Madje, ky korrelacion është më i shprehur në vendet me resurse të kufizuara, të cilat kanë popullatë më të re dhe numër më të vogël të shtretërve spitalorë.

Mesatarja e testimit në 169 shtete ishte 3.75 teste në 100 banorë. Rritja e vetëm një testi në mesataren e përgjithshme prej 100 banorësh, e ka ulur për 8% shkallën e vdekshmërisë.

Rritja e testimeve, rritja e efektivitetit qeveritar dhe rritja e shtretërve spitalorë mund të ndikojnë në uljen e vdekshmërisë ndaj Covid-19.

<https://www.nature.com/articles/s41598-020-68862-x>

[https://www.thelancet.com/journals/eclinm/article/PIIS2589-5370\(20\)30208-X/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/eclinm/article/PIIS2589-5370(20)30208-X/fulltext)

3. TË MBAHET TESTI I ARRITSHMËRISË DHE TESTI I MATURËS

- Këshillohet të mbahen testet e Arritshmërisë dhe ai i Maturës, me zbatim strikt të masave parandaluese anti COVID-19 nga MASHT.
- Vendimi përfundimtar do të varet nga situata epidemiologjike në vend dhe nga qëndrimi që do të marrin IKSHPK dhe MASHT.
- Sygjerohet që në klasë të mos ketë më shumë se 12 nxënës dhe distanca mes tyre të jetë më e madhe se 2 metra.

Për dhënien e këtij rekomandimi janë kryer konsultime në MASHT, në DKA Prishtinë, Pejë dhe me ekspertë të arsimit.

3.1. Nevoja për organizimin e testit

Matura është kërkesë dhe detyrim ligjor për pranim në Universitet.

Testi i arritshmërisë ndihmon shumë në fazën e regjistrimit në klasën e 10-të, sepse u ndihmon nxënësve të orientohen në drejtimet për të cilat kanë më shumë prirje dhe në të cilat janë më të suksesshëm.

Praktikisht: Ka interesim të shtuar për regjistrim në shkolla të mjekësisë dhe në gjimnaze – veçanërisht në qytetet e mëdha - gjë që krijon presion të shtuar në shkolla dhe në drejtoritë komunale.

3.2. Argumentet në favor të organizimit të testeve:

- MASH ka të kryera të gjitha përgatitjet për realizimin e testeve (për maturë dhe testin e arritshmërisë).
- Testet janë te nevojshme për regjistrim në nivelin e ardhshëm.
- Çdo alternativë rrezikon të shtojë mundësinë dhe rastet e praktikave korruptive (nga të gjitha palët e interesuara) për regjistrim në shkollat e preferuara.
- Disa alternativa janë prapë teste – mirëpo këto nuk janë të standardizuara dhe nuk e shmangin mundësinë e praktikave korruptive.
- MASHT dhe komunat mund të sigurojnë kushte optimale për realizimin e testeve (hapësira e mjaftueshme, dezinfektimi, distanca, vendosja e rendit).
- Pëtr të anuluar testin e maturës, duhet vendim ose zgjidhje në nivel të Parlamentit të Kosovës.

3.3. Argumentet kundër organizimit të testeve:

Frika nga ekspozimi i fëmijëve dhe puntorëve arsimorë ndaj rrezikut të infektimit me virusin COVID - 19.

Gjendja e përkeqësuar me numrin e infeksioneve dhe viktimave në Kosovë

Mundësia që të rregullohet regjistrimi i nxënësve në nivelin tjetër (klasa e 10 ose në Universitet) me zgjidhje alternative (hartimi i kriterëve të pranimit sipas fushave kurrikulare, lëndëve relevante, ose testeve të pranimit (përfshirë edhe teste online - siç është menduar në komunën e Prishtinës).

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përgatitur një version rezervë për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të.

Universitetet mund të organizojnë teste pranuese për kandidatët për regjistrim

- Disa vende e kanë anuluar maturën dhe testet e standardizuara (SHBA, Britani, Gjermani, Maqedoni)

MASH është gati për të dyja skenaret - edhe për organizim të testeve; edhe për aplikim të alternativave;

Rekomandim final:

- Këshillohet të mbahen testet e Arritshmërisë dhe ai i Maturës, me zbatim strikt të masave parandaluese anti COVID-19 nga MASHT.

4. SHKOLLAT

Çështja e hapjes së shkollave do të diskutohet në mbledhjen e radhës bashkë me referencat e fundit nga institucionet arsimore, profesionale dhe shkencore.

Në parim, Bordi njëzëri miratoi propozimin që të zbatohet modeli i kombinuar i hapjes së shkollave.

- Parashkollorët dhe nxënësit deri në klasën e pestë të vijojnë mësimin në shkolla.
- Të hapen shkollat profesionale për mbajtjen e lëndëve profesionale dhe atyre praktike. Lëndët joprofesionale të mbahen online.
- Në Fakultetin e Mjekësisë, ligjëratat të mbahen online, kurse ushtrimet të mbahen nëpër klinika dhe institute të SHSKUK dhe IKSHPK. Të merret në konsideratë edhe ndihma e absolventëve të FM në përballje me COVID-19.

5. SPORDET

Miratohet kërkesa e Komitetit Olimpik të Kosovës, sipas të cilës:

1. Lejohen të stërviten sportistët e përzgjedhur elitare (6 nga këta sportistë janë me normë olimpike), dhe sportistët tjerë që kanë gjasa reale të arrijnë normën olimpike. Stërvitjet organizohen nën masa të zbatimit të protokollit të MSH për parandalimin e COVID-19. Për mbarëvajtjen e këtij procesi përgjegjësinë e bartin Federatat, klubet dhe vetë sportistët.

Sportet e kësaj kategorie elitare që lejohen për stërvitje janë:

- Xhudo
- Mundja
- Karate
- Boksi
- Atletika dhe
- Noti.

Këshillohet që garuesit e këtyre sporteve elitare të bëjnë testime të rregullta.

2. Lejohet stërvitja e klubeve të kualifikuara në garat Evropiane, që vijnë nga këto sporte:

- Futbolli
- Futsalli
- Hendbolli
- Volejboli

3. Sportet individuale janë lejuar me vendimin e fundit të Qeverisë. Komiteti Olimpik i Kosovës ka sjellë listën e detajuar të këtyre sporteve:

- Atletika
- Noti
- Shigjetaria
- Badmintoni
- Çiklizmi,
- Automobilizmi
- Aeronautika

- Motorizmi
 - Gjinnastika
 - Tenisi
 - Ping-pongu
 - Shenjëtaria
 - Shigjetaria
 - Triatlloni
 - Volejboli në rërë,
 - Bjeshkataria
 - Skijimi
 - Biliardo
 - Boullingu
 - Pikado
 - Minigolfi
-
- Garat në Kosovë, ceremonitë e ndryshme, Kuvendet dhe tubimet e Federatave ndalohen për të gjitha sportet dhe kategoritë (me përjashtim të sporteve që janë kualifikuar për garat Evropiane).

6. TË TJERA

- Kërkohet që raportet e mbledhjeve të Bordit të bëhen publike në veb faqen e Ministrisë së Shëndetësisë.

PJESËMARRËSIT NË TAKIM:

1. Xhavit Rexhaj
2. Sanije Xhemajli
3. Ferid Agani
4. Isme Humolli
5. Pashk Buzhala
6. Xhavit Gashi
7. Lul Raka